



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1093/8 Prot

Tiranë, më 2.8.2023

VENDIM

Nr. 34, datë 2.8.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1093 Prot., datë 14.06.2023, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” (në vijim, “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës datë 19.05.2023, depozituar në adresën elektronike nexhila.kodra@shendetesia.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me nr. reference REF-37187-07-26-2022 me objekt “*F. V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore*”, konkretisht:

1. *Kopje të Urdhërit të Prokurimit;*
2. *Kopje të dokumentacionit në lidhje me analizën e tregut për përcaktimin e fondit limit;*
3. *Kopje të Urdhërit për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave;*
4. *Kopje të Raportit të Vlerësimit dhe kopje të raportit përmbledhës të komisionit të vlerësimit të ofertave;*

5. *Kopje të Ofertës së fituesit të kontratës;*
6. *Kopje të Kontratës së nënshkruar më fituesin e procedurës së prokurimit;*
7. *Kopje të Faturave dhe pagesat e kryera;*
8. *Kopje të Vërtetimit të Realizimit me sukses të procedurës së prokurimit.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 19.05.2023.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 1093/1 prot., datë 15.06.2023 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion si dhe sqarime për zotërimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 22.06.2023.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 2389/1 Prot., datë 22.06.2023, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 1093/2 Prot., datë 26.06.2023 ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“...Procedura prokurimit e kërkuar me nr. reference REF-37187-07-26-2022 me objekt “F. V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore”, me fond limit 12,800,000 (dymbëdhjetë milion e tetëqind mijë) Lekë pa TVSH, është një procedurë e zhvilluar me mjete elektronike në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al dhe për rrjedhojë informacioni mbi të është i aksesueshëm nga çdo person i interesuar, bashkëlidhur gjendet Formulari i Njoftimit të Fituesit për procedurën e kërkuar dhe Buletinin Nr. 139, datë 10 Tetor 2022 ku mund të gjeni informacionin e kërkuar.*

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, nëpërmjet emailit datë 26.06.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1093/3/2 Prot., datë 27.06.2023, ka vijuar ankimin me pretendimin se: *“Së pari, nëse informacionet e kërkuara gjenden të publikuara sipas pretendimit të autoritetit publik, ky i fundit duhet të adresojë linkun e saktë ku gjenden të publikuara dhe jo referimin e faqes zyrtare të APP-së. Së dyti, bëjmë me dije, se informacioni i kërkuar është informacion, i cili nuk publikohet në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, dhe e vetmja mënyrë për tu informuar është nëpërmjet*

kërkesës për informacion. Për sa më sipër, duke qenë se autoriteti publik nuk ka përmbushur detyrimin për dhënien e informacionit sipas objektit të kërkesës, kërkojmë vijimin e ankimit dhe detyrimin e autoritetit publik, për të vënë në dispozicion informacionin sipas objektit të kërkesës për informacion.”

Në këto kushte, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 102, datë 05.07.2023, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 10.07.2023. Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ, i cili u protokollua me nr. 2389/2 Prot., datë 07.07.2023.

Gjatë inspektimit të ushtruar, duke qenë se struktura përgjegjëse, e cila kishte përgatitur përgjigjen e kthyer ankuesit, në momentin e inspektimit konkretisht, drejtoresha e Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve ndodhej me leje të zakonshme, përfaqësuesit e Autoritetit Publik kërkuan kohë deri me datë 19.07.2023, për të rivlerësuar edhe njëherë qëndrimin e mbajtur në shkresën nr.2389/1 Prot., datë 22.06.2023.

Në vijim, me shkresën nr. 2389/3 Prot., datë 27.07.2023, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: *“...Duke qenë se një pjesë e dokumentacionit të kërkuar (i cili nuk publikohet në www.app.gov.al) i përket fushës së zbatimit të nenit 81 “E drejta për informim” dhe nenit 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përpara se të vendosë në dispozicion kopje të tij, do t’i drejtohet me kërkesë për interpretim Agjencisë së Prokurimit Publik në mënyrë që të mos veprojë në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale ose të çënojë interesin publik apo interesat ligjore dhe ekonomike të palëve, ose të pengojë konkurrencën e drejtë. Bashkëlidhur gjeni Formularin e Njoftimit të Fituesit për procedurën e kërkuar dhe Buletinin Nr. 139, datë 10 Tetor 2022 ku mund të gjeni informacionin e kërkuar sipas nenit 99 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.*

Nga konsultimi i legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me objektin e kërkesës për informacion datë 19.05.2023, duke mos përmbushur në këtë mënyrë dispozitat dhe parimet e LDI.

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesës ka të bëjë me një kontratë, e cila i nënshtrohet gjithashtu dispozitave të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas të cilit: *“Duke qenë se informacioni i kërkuar është një procedurë e zhvilluar me mjete elektronike në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al dhe për rrjedhojë informacioni mbi të është i aksesueshëm nga çdo person i interesuar”,* Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Në përgjigjen e dhënë, konstatohet se Autoriteti Publik ka

referuar faqen zyrtare të institucionit, ku pretendon se është publikuar informacioni dhe jo adresën e saktë të tij, në mënyrë të tillë që informacioni të gjendet lehtësisht nga kërkuesi.

Ky qëndrim i Autoritetit Publik vjen në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...”*. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, duhet t'i tregojë ankuesit adresën e saktë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilën gjendet informacioni i kërkuar.

Theksojmë se, një pjesë e informacionit të kërkuar bën pjesë në atë kategori informacioni, që duhet të bëhet publik pa kërkesë. Çdo autoritet publik, bazuar në pikën e) të nenit 7 të LDI, duhet të ketë publik në programin e transparencës *informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik privat, duke përfshirë:*

- i. listën e kontratave të lidhura;
- ii. shumën e kontraktuar;
- iii. palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
- iv. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

Sa i përket dokumentacionit, i cili nuk gjendet në faqen e Autoritetit Publik apo të Agjencisë së Prokurimit Publik, ju bëjmë me dije se LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar*. Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vendosen në dispozicion nga autoriteti publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti (sipas pikës 1 të nenit 7 të LDI), ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, pasi kemi të bëjmë me një kërkesë për informim të depozituar pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI.

Gjithashtu, dokumentacioni (*hard copy*) i vendosur në dispozicion me shkresën nr. 2389/1 Prot., datë 22.06.2023 dhe shkresën nr. 2389/3 Prot., datë 27.07.2023, nuk është në përputhje me dokumentacionin e kërkuar në kërkesën për informacion datë 19.05.2023. Konfirmuar ky fakt edhe nga ankuesi, i cili në vijimin e ankimit ka kërkuar detyrimin e Autoritetit Publik, për të vënë në dispozicion informacionin sipas objektit të kërkesës

Lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik se: *“...Përpara se të vendosë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, do t'i drejtohet me kërkesë për interpretim Agjencisë së*

Prokurimit Publik...”, Komisioneri vlerëson se ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ka qartësuar në nenin 21 të tij se, përgjegjësia për administrimin e të gjithë dokumentacionit për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit është e autoritetit ose entit kontraktor.

Për më tepër, fryma e përgjithshme e legjislacionit të sipërcituar është të sigurojë integritet, besim në publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, nga ana e Autoriteteve Publike, duke bërë publik sa më tepër informacion që lidhet me këto procedura dhe jo duke e kufizuar atë.

Komisioneri ka krijuar një praktikë të konsoliduar tashmë përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme, vendimmarrje, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare, në linkun <https://www.idp.al/vendime-ddi/>, konkretisht, Vendimi nr. 8, datë 22.04.2022, Vendimi nr. 14, datë 13.05.2022, Vendimi nr. 16, datë 24.05.2022, etj.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe në kushtet kur Autoriteti Publik pranon se e disponon dokumentacionin, objekt ankese, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuases çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur

ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve. Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: “*Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...*”.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1093 Prot., datë 14.06.2023, nga Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës sipas kërkesës për informacion datë 19.05.2023, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (*Kopje të Urdhërit të Prokurimit; Kopje të dokumentacionit në lidhje me analizën e tregut për përcaktimin e fondit limit; Kopje të Urdhërit për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave; Kopje të Raportit të Vlerësimit dhe kopje të raportit përmbledhës të komisionit të vlerësimit të ofertave; Kopje të Ofertës së fituesit të kontratës; Kopje të Kontratës së nënshkruar më fituesin e procedurës së prokurimit; Kopje të Faturave dhe pagesat e kryera; Kopje të Vërtetimit të Realizimit me sukses të procedurës së prokurimit*), brenda datës 09.8.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 02.8.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi